

**VENDIM**  
**Nr.1457, datë 10.10.2008**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT**  
**RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 35 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pas nenit 71 të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, që i bashkëlidhet vendimit nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet neni 71/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 71/1

**Auditimi i sigurisë rrugore (neni 35 i Kodit Rrugor)**

1. Auditimi i sigurisë rrugore nënkupton kontrollin e projektit për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve, si dhe të projekteve të sinjalizimit rrugor apo instalimeve të tjera të trafikut, për të zbuluar e parandaluar gabimet në projektim a zbatim, të cilat përbëjnë rrezik për ndodhjen e aksidenteve rrugore. Auditimi është mbështetje për entin pronar të rrugës, personin përgjegjës të projektit, si dhe atë zbatues të punimeve. Ai kryhet sipas metodave standarde, të përcaktuara me udhëzim të ministrit që mbulon veprimtarinë e transportit.

2. Auditimi i sigurisë rrugore kryhet nga persona, fizikë ose juridikë, të cilët kanë përvojë pune mbi 5 vjet në fushën e sigurisë rrugore. Auditimi i sigurisë rrugore kryhet, së paku, nga dy auditues.

3. Rregullat, kriteret, procedurat dhe dokumentacioni për përzgjedhjen e personave, të cilët do të kryejnë auditimin e sigurisë rrugore, përcaktohen me udhëzim të ministrit, që mbulon veprimtarinë e transportit dhe të Ministrit të Brendshëm.

4. Çdo projekt për ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve a instalimeve të tjera të trafikut, ku kostoja e projektit e kalon vlerën 5 milionë lekë, do të auditohet, nga pikëpamja e sigurisë rrugore, dhe audituesi caktohet në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Kur kostoja e projektit ka vlerë nën 5 milionë lekë, audituesi caktohet nga titullari i autoritetit kontraktor.

5. Auditimi i sigurisë rrugore kryhet në fazat e projektit paraprak, të projektit dhe gjatë të gjithë fazës së punimeve në rrugë. Ai mund të kryhet në fazat e fillimit të punimeve në rrugë dhe para marrjes në dorëzim të punimeve të kryera. Auditimi kryhet edhe në rrugët ekzistuese.

6. Grupi i auditimit të sigurisë rrugore paraqet raport me shkrim, ku trajton edhe ndryshimet në projekt, që ai rekomandon, si dhe arsyet. Ky raport i dërgohet subjektit projektues dhe, për dijeni, edhe entit pronar të rrugës.

7. Subjekti projektues deklaron, me shkrim, nëse i pranon a i refuzon rekomandimet e raportit, duke paraqitur, me shkrim, arsyet e refuzimit apo duke dhënë një zgjidhje tjetër, nga ajo e propozuara.

8. Raportet e audituesve dhe deklaratat, e përmendura në pikën 7 të këtij vendimi, i bashkëlidhen dokumentacionit tjetër të projektit.

9. Në rastin e auditimit të sigurisë rrugore në rrugët ekzistuese, grupi i auditimit i dorëzon entit pronar të rrugës, së cilës i bëhet auditim, një raport, me shkrim, ku parashtron të gjitha

problemet e vëna re dhe propozimet për zgjidhjen e tyre.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

**Sali Berisha**